

E uend?



REPUBLIKA E SHqipëRIE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
MINISTRI

URDHËR

Nr 4799, datë 15.5. 2017

**“PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 1425, DATË 19.02.2015 “PËR MIRATIMIN
E RREGULLORES SË FUNKSIONIMIT TË FONDIT NË MBËSHTETJE TË
SIPËRMARRJEVE TË REJA “START-UP”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 835, datë 18.9.2013 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes”, të ndryshuar dhe të pikës 9 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 593, datë 10.09.2014 “Për krijimin e Fondit në mbështetje të Sipërmarrjeve të reja “Start-up”, të ndryshuar

URDHËROJ:

- Në pikën 7, të Rregullores së funksionimit të fondit në mbështetje të sipërmarrjeve të reja “Start-up”, miratuar me Urdhrin nr. 1425, datë 19.02.2015 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të fondit në mbështetje të sipërmarrjeve të reja “Start-up”, në përgjegjësitë e “Menaxherit të Skemës”, pas paragrafit “Sigurimin e të gjithë dokumentacionit.....” shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:
 - “Njoftimin e Ministrit përgjegjës, 5 (pesë) ditë para mbledhjes së KAG, lidhur me aplikimet (sipas modelit bashkëlidhur) si dhe axhendën e Komisionit”.
- Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

 MILVA EKONOMI

